Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR MINISTRINË E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2018

Prishtinë, qershor 2019

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Qerkin Morina, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Albesa Tolaj-Ramosaj udhëheqëse e ekipit, Arta Birinxhiku dhe Aurora Morina anëtare të ekipit, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Bujar Bajraktari.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme....4

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit....6

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm....7

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli....10

4 Qeverisja e mirë....25

5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve....28

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA....34

Shtojca II: Letër konfirmimi....36

Përmbledhje e përgjithshme

Raporti përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Ministrisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për vitin 2018, i cili përfshin Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2018 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 29.11.2018.

Auditimi është fokusuar në:



Niveli i angazhimit për të kryer auditimin është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson Menaxhmentin e lartë dhe stafin e Ministrisë, për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

Opinioni i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2018 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se regjistri i pasurisë nuk ishte i plotë dhe i besueshëm, si dhe shpalosja e pasurive dhe detyrimeve kontigjente në PFV nuk ishte e saktë.

Më gjerësisht shih Pjesën 2.1 të këtij Raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e opinioneve, sipas SNISA-ve.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore

Theksimi i Çështjes pasqyron dobësitë dhe mosefikasitetin në regjistrimin e plotë dhe shpalosjen e pasurive dhe detyrimeve kontingjente në PFV.	Ministrja duhet t'i analizoj arsyet për përsëritjen e Theksimit të Çështjes dhe t'i ndërmarrë veprimet e nevojshme për të mundësuar një prezantim të drejtë dhe të saktë të pasurive dhe detyrimeve kontingjente në PFV-të e vitit 2019 (shih kapitullin 2.1).
Planifikimi i buxhetit, shpenzimet në kategorinë e investimeve kapitale, subvencioneve, mallra dhe shërbime dhe pagave janë fusha të përcjellura me dobësi.	Ministrja duhet të aplikoj një vlerësim të detajuar të dobësive në fushat e theksuara në këtë Raport, si dhe të përcaktoj veprimet e nevojshme për t'i adresuar ato (shih kapitullin 3).
Përgjigja ndaj rekomandimeve të vitit paraprak nuk po adresohet në nivelin e kërkuar, dhe rrjedhimisht, përmirësimet e organizatës janë të ngadalshme.	Ministrja duhet ta zbatoj një proces rigoroz për të siguruar se trajtimit të rekomandimeve i kushtohet rëndësia e duhur, duke zbatuar edhe një monitorim në baza të rregullta.
Komiteti i Auditimit nuk ishte funksional as gjatë vitit 2018 .	Ministrja duhet të sigurojë funksionimin e Komitetit të Auditimit, i cili duhet t'i rishikojë rezultatet e auditimit të brendshëm, përfshirë cilësinë e raporteve dhe veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti.

Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2018

Menaxhmenti është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresoj të gjitha rekomandimet e dhëna.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase.
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Ne kemi analizuar veprimtarinë e Ministrisë, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e AP-së.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste substanciale si dhe aranzhimet e të qeverisjes, deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përmbledhje të detajuar të gjetjeve tona të auditimit dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Përgjigjet e menaxhmentit në rezultatet e auditimit mund ti gjenden në Shtojcën II.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm

Auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese dhe cilësinë e saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV, përfshirë deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Ne kemi audituar PFV-të e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, shpalosjet dhe raportet tjera përcjellëse.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se:

- Vlera e pasurive kapitale e prezantuar në PFV ishte nënvlerësuar për 114,533€, të cilat nuk ishin regjistruar në regjistrat e pasurisë. Edhe vlera e pasurive nën 1,000€ e prezantuar në PFV nuk ishte e saktë. Prezantimi i vlerës ishte bërë sipas regjistrave të brendshëm e cila ishte për 16,100€ më e vogël sesa vlera në regjistrin e sistemit e-pasuria. Kjo, sipas ministrisë kishte ndodhur si rezultat i mos funksionimit të sistemit të e-pasurisë. Për më tepër, pasuritë në vlerë prej 6,300€ nuk ishin regjistruar në regjistrat e pasurisë.

Po ashtu, pronat tokësore të Institutit Bujqësor të Kosovës (IBK) në vlerë 7,652,967€, ende nuk kontrollohen dhe shfrytëzohen nga IBK, por të njëjtat shfrytëzohen nga individët privat. Ky vlerësim është bazuar në të dhënat e Agjencisë Kadastrale të Kosovës (AKK) ku titullar i pronave figuron IBK. Kjo e gjetur ishte paraqitur edhe në raportin e vitit paraprak.

- Shpalosja e pasurive kontingjente dhe detyrimeve kontingjente nuk ishte pasqyruar drejt në PFV. Vlera e pasurive kontigjente ishte e mbivlerësuar për 163,474€, ndërsa detyrimet kontingjente ishin nënvlerësuar për 35,841€. Këto dallime ishin vërejtur nga krahasimet e bëra në mes të PFV-ve dhe regjistrave të brendshëm të ministrisë.

Çështjet kyçe të auditimit

Si rezultat i menaxhimit jo të mirë në fushën e subvencioneve MBPZhR në fund të vitit 2018 kishte detyrime të pa paguara ndaj fermerëve për subvencione dhe grante në shumën prej 3,575,011€, për të cilat ishte lëshuar vendimi për pagesë por në mungesë të mjeteve nuk ishte realizuar pagesa e tyre. Po ashtu, ministria kishte detyrime kontraktuale prej 19,853,257€ të cilat u janë aprovuar fermerëve sipas programit vjetor për zhvillimin e bujqësisë dhe programit të veçantë për zonat me pak të zhvilluara në regjionin e Mitrovicës Veriore dhe Masës për investimet në infrastrukturën rurale (projektet e subvencionuara nga këto mjete pritet të përfundohen gjatë vitit 2019). Në krahasim me vitin paraprak ka rritje të dukshme të këtyre obligimeve. Kjo ka ndodhur si pasojë e:

- Vonesave në aprovimin e programit për pagesat direkte dhe programit për zhvillim të bujqësisë, të cilat kanë shkaktuar vonesa në proces, përfshirë thirrjen për aplikim, vlerësimin dhe miratimin e aplikacioneve, kontrollet në terren e deri te finalizimi i pagesës,
- Kryerja e obligimeve të bartura nga viti paraprak,
- Aprovimi i programit të veçantë për zonat me pak të zhvilluara në regjionin e Mitrovicës Veriore dhe Masës për investimet në infrastrukturën rurale; dhe
- Transferi i mjeteve nga kategoria e subvencioneve në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve.

Me buxhetin e vitit 2019, ministrisë i janë ndarë 47,657,022€, prej të cilave 43,426,314€ nga granti qeveritar dhe 4,230,708€ nga fondet e huamarrjes. Siç shihet, gati gjysma e buxhetit 2019 duhet të shpenzohet për mbulimin e detyrimeve nga viti paraprak, dhe kjo mund të reduktoj programet e zhvillimit të vitit 2019.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

MBPZhR kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Kërkesat e LMFPP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;

- Pajtueshmërinë me Rregullat Financiare nr. 01/2013 për shpenzimin e parave publike dhe Rregullën Financiare nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve; dhe
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK).

DEKLARATA E BËRË NGA MENAXHMENTI I MBPZhR-së

Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në Ministrinë e Financave, mund të konsiderohet e saktë, përveç të gjeturave te theksimi i çështjes.

2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Për çështjet e sipër përmendura jepen rekomandimet:

Rekomandimi B1 Ministrja duhet të siguroj shpalosjen e saktë të të gjitha informatave në PFV, përfshirë informatat në lidhje me pasuritë, pasuritë kontingjente dhe detyrimet kontingjente. Kësaj duhet t'i paraprij evidentimi dhe regjistrimi i tyre në regjistrat e ministrisë. Po ashtu, Ministrja dhe Drejtori i Përgjithshëm i IBK-së duhet të sigurojnë se janë ndërmarrë veprimet e duhura ligjore që pasuritë e shfrytëzuara nga personat privat të rikthehen nën kontroll të IBK-së.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve. Në mënyrë të veçantë, ne kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, prokurimin, burimet njerëzore, pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi të hyrat në përgjithësi janë të përshtatshme dhe janë duke u zbatuar në mënyrë efektive, por kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtejshëm për të parandaluar parregullsitë eventuale. Fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime janë realizimi i buxhetit tek investimet kapitale, procedimi i pagesave dhe menaxhimi i subvencioneve. Për më tepër, fusha e prokurimit vazhdon të mbetet shqetësuese për shkak të mos realizimit të planit dhe vonesave në përfundimin e projekteve. Më tej, ministria dhe agjencitë në kuadër të saj vazhdojnë të angazhojnë zyrtarë me marrëveshje për shërbime të veçanta (MShV), në pozitat e rregulla të punës. Menaxhimi i pasurisë si dhe shpalosja e pasurive dhe detyrimeve kontingjente kanë nevojë të përmirësohen.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final[1]	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
Burimet e Fondeve:	**60,001,082**	**59,097,213**	**52,675,811**	**50,811,220**	**50,857,566**
Granti i Qeverisë - Buxheti	53,020,252	51,988,910	50,545,984	49,742,305	47,719,241
Financimi përmes huamarrjes	6,980,830	6,980,830	2,006,038	516,714	2,927,584
Të hyrat vetjake[2]	0	127,473	123,789	56,042	89,751
Donacionet e jashtme	0	0	0	402,435	39,972

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 903,869€. Granti i Qeverisë ishte zvogëluar për 1,031,342, por rritje të buxhetit prej 127,473€ kishte nga të hyrat vetjake të Agjencionit Pyjor të Kosovës.

[1] Buxheti Final – Buxheti i aprovuar nga Kuvendi dhe i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
[2] Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e aktiviteteve vetjake.

Në vitin 2018, ministria ka shpenzuar 89% të buxhetit final ose 52,675,811€, me një rënie prej 3% krahasuar me vitin 2017. Realizimi i buxhetit nga huamarrja ishte në nivel jo të kënaqshëm me një shkallë shpenzimi prej vetëm 29%. Kjo ka ndikuar që edhe përqindja e përgjithshme e shpenzimeve të jetë më e ulët. Më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	**60,001,082**	**59,097,213**	**52,675,811**	**50,811,220**	**50,857,566**
Pagat dhe Mëditjet	2,467,297	2,547,323	2,547,323	2,330,329	2,180,904
Mallrat dhe Shërbimet	3,363,681	4,491,154	3,648,813	2,416,802	3,570,786
Shërbimet komunale	135,660	127,014	78,921	100,826	99,572
Subvencionet dhe Transferet	47,657,022	46,655,993	43,667,249	43,868,507	43,894,912
Investimet Kapitale	6,377,422	5,275,729	2,733,505	2,094,756	1,111,392

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore përfshirë arsyet dhe ndikimin që kanë pasur:

- Buxheti final për paga dhe mëditje ishte rritur për 80,026€ në krahasim me buxhetin fillestar. Kjo rritje ishte me vendim të Qeverisë, shumë e cila ishte shpenzuar në tërësi.
- Buxheti final për mallra dhe shërbime ishte rritur për 1,127,473€, në raport me buxhetin fillestar. Kjo rritje ishte rezultat i të hyrave vetjake nga viti 2017 në vlerë prej 127,473€ të cilat i janë bartur Agjencisë Pyjore të Kosovës (APK) me buxhetin final, dhe 1,000,000€ si rezultat i vendimit të Ministrit Ref.KM-221/18 që i jep të drejtën Sekretarit të Përgjithshëm të bëjë transferin e mjeteve nga subvencionet dhe transferet në kategorinë mallra dhe shërbime. Transferi ishte bërë me qëllim të shlyerjes së obligimeve ndaj operatorëve ekonomik (OE) për tri projekte[3]. Niveli i realizimit në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve ishte 81% e buxhetit final apo 3,648,813€.
- Buxheti final për subvencioneve dhe transfereve, në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 1,001,029€. Pjesa prej 1,000,000€ ishte transferuar në mallra dhe shërbime si rezultat i vendimit të cekur më lartë, ndërsa shuma prej 1,029€ ishte marrë me vendim të Qeverisë në emër të kursimeve buxhetore. Shpenzimi i buxhetit në këtë kategori ishte 94% e buxhetit final. Suficiti i mjeteve prej 2,988,744€ është nga fondi 04-Finacime nga Huamarrjet,

[3] Dezinfektimi i hapësirave të ekspozuara për ethet hemorragjike Krime-Kongo në fshatrat e Komunës së Malishevës;
Konsolidimi dhe Inventarizimi i tokave bujqësore;
Mirëmbajtja, zhvillimi dhe përforcimi i Kadastrit të Vreshtarisë, sistemi për menaxhimin e cilësisë së verës, dhe pijeve të forta alkoolike në rajonin vreshtar të Republikës së Kosovës.

fond i cili ka qenë i planifikuar për projekte të Programit të Zhvillimit Rural dhe arsyeja e mos shpenzimit të këtyre mjeteve ishte vonesa në aprovim të Programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural.

- Buxheti final për investimet kapitale ishte zvogëluar për 1,101,693€ në krahasim me buxhetin fillestar. Këto mjete janë marrë me vendim të Qeverisë në emër të kursimeve buxhetore. Gjatë vitit 2018 ishin shpenzuar vetëm 52% e buxhetit final. Në buxhet ishin planifikuar 15 projekte (12 projekte në vazhdim nga vitet e kaluara dhe 3 projekte të reja). Vonesat në zbatim të projekteve janë të dukshme, si rezultat i vonesave në fillimin e procedurave të prokurimit, nënshkrimit të kontratave në fund të vitit, anulime të procedurave të prokurimit dhe ankesave të Operatorëve Ekonomik (OE) në Organin Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) si dhe hartimit të dobët të projekteve dhe specifikimeve teknike nga njësitë kërkuese.
- Buxheti i shërbimeve komunale ishte zvogëluar me vendim të qeverisë për 8,646€. Realizimi për këtë kategori ishte 78,921€ apo 62% e buxhetit final.

Çështja B2[4] – Performancë e dobët në menaxhimin dhe ekzekutimin e buxhetit

Gjetja

Realizimi i buxhetit duhet të bëhet në pajtim me Ligjin nr. 06/L-020 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2018, si dhe në harmoni me rrjedhën e parasë së gatshme.

Realizimi i buxhetit për vitin 2018 tregon performancë jo të mirë sidomos tek mallrat dhe shërbimet dhe investimet kapitale ku është dashur të bëhen përshtatje gjatë vitit. Po ashtu, transferi i mjeteve (1,000,000€) nga subvencionet në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, ndërkohë që shumëfish më shumë ministria kishte obligime të pa paguara gjatë vitit ndaj përfituesve të granteve dhe subvencioneve. Kjo flet për një menaxhim jo të mirë të ndarjeve buxhetore. Për më tepër, transferi i mësipërm nuk është i kuptueshëm, përderisa në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve në fund të vitit kishte fonde të pashpenzuara prej 842,341€. Kjo ka ardhur si rezultat i vonesave në aprovim të Programeve për Bujqësi dhe Zhvillimi Rural dhe Pagesave Direkte në Bujqësi si dhe vonesave në nënshkrim të kontratave të prokurimit si pasojë e vonesës në inicimin e procedurave, për shkak të ankesave dhe kontesteve në OSHP etj.

Rreziku

Mos realizimi i buxhetit në përputhje me ndarjet buxhetore të vitit, rezulton me shfrytëzim joefikas të burimeve në dispozicion, si dhe mund të rezultojë në mos arritjen e objektivave të ministrisë.

Rekomandimi B2

Ministrja duhet të siguroj monitorim sistematik të shpenzimit të buxhetit. Për tejkalimin e barrierave eventuale të identifikuara, duhet të përcaktohen masa konkrete dhe praktike në mënyrë që ekzekutimi i buxhetit të bëhet në harmoni me planin e shpenzimeve. Programet vjetore të bujqësisë duhet të aprovohen me kohë, për të mundësuar shmangien e bartjes së vazhdueshme të obligimeve për vitin pasues.

3.1.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga ministria për vitin 2018 ishin në vlerë 2,343,777€. Të hyrat realizohen nga lëshimi i licencave, të hyrat nga qiraja e tokës së dhënë në shfrytëzim, taksat drusore, etj. Shuma 1,991,102€ apo rreth 81% e të hyrave totale janë realizuar nga APK, ndërsa pjesa tjetër është realizuar nga departamentet tjera.

[4] Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C - nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.

Tabela 3. Të hyrat vetjake (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2018 Pranimet	2017 Pranimet	2016 Pranimet
Të hyrat vetjake	1,898,660	1,898,660	2,343,777	2,265,297	1,949,985
Totali	**1,898,660**	**1,898,660**	**2,343,777**	**2,265,297**	**1,949,985**

Vlera e të hyrave të arkëtuara gjatë vitit 2018, ishte më e lartë për 78,480€ në krahasim me vitin paraprak ku ishin arkëtuar 2,265,297€.

Ministria ka vendosur një gamë kontrollesh që kanë të bëjnë me mbledhjen dhe raportimin e të hyrave, përfshirë raportimin e të hyrave në Pasqyrat Financiare.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë

3.1.2 Pagat dhe mëditjet

Pagat dhe shtesat paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave që menaxhohet nga MF. Megjithatë janë një sërë kontrollesh të cilat operojnë në kuadër të MBPZhR-së, e të cilat ndërlidhen me autorizimin e listës së pagave, ndryshimin e listës së pagave dhe reflektimin e ndryshimeve të ndodhura. Numri i planifikuar i punonjësve ishte 398, ndërsa numri aktual ishte 391.

Buxheti final për kategorinë e pagave dhe mëditjeve ishte 2,547,323€, dhe ishte realizuar në tërësi. Pavarësisht që ministria nuk kishte plotësuar numrin e të punësuarve të planifikuar, realizimi i buxhetit ishte 100%. Numri i të punësuarve në kabinetin e ministrit ishte shtuar nga 14 sa ishin të planifikuar me buxhet, në 24 zyrtarë. Ky shtim ishte rezultat i vendimeve të qeverisë për emërimin e zëvëndës ministrave të cilët kanë edhe staf mbështetës. Pagat e larta të zyrtarëve të kabinetit në krahasim me pozitat e aprovuara me buxhet, kanë bërë që përkundër mosplotësimit të numrit të punëtorëve, buxheti të shpenzohet në tërësi. Në anën tjetër në APK ishin aprovuar me buxhet 158 pozita ndërsa ishin të plotësuara 148, në AZhB ishin planifikuar 68 pozita derisa ishin plotësuar 65[5], etj.

Lidhur me çështjet e personelit, kemi identifikuar si vijon:

[5] Plotësimi i tri pozitave të lira ishte në proces dhe në vitin 2019 është kompletuar.

Çështja A1 – Angazhimi me MShV në pozitat e rregullta të punës dhe më gjatë se gjashtë muaj

Gjetja

Sipas Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, pika 4 e nenit 12, emërimet me afat të caktuar për një periudhë më të shkurtër se gjashtë (6) muaj do të bëhen në bazë të kontratave të quajtura "Marrëveshje për shërbime të veçanta" të cilat i nënshtrohen Ligjit për Detyrimet dhe për të cilat zbatohet një procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit.

Ministria edhe gjatë vitit 2018 ka vazhduar të angazhoj zyrtarë me MShV. Angazhimi i tyre ishte bërë kryesisht në pozita të rregullta të punës ku do të duhej të punësoheshin zyrtar me kontrata të rregullta. Po ashtu, ne kemi vërejtur se afatet e lejuara ligjore të angazhimit me MShV ishin tejkaluar. Kjo është konfirmuar në 44[6] nga 56 mostrat e testuara, dhe tejkalimi i afateve ishte nga shtatë (7) muaj deri në tetë (8) vite.

Kjo gjendje sipas ministrisë ishte si rezultat i mungesës së mjeteve buxhetore në kategorinë e pagave dhe mëditjeve dhe nevojës së madhe për shtimin e numrit të punëtorëve si rezultat i volumit të madh të punëve në disa departamente.

Rreziku

Angazhimi i personave me MShV në pozita të rregullta të punës si dhe tejkalimi i afatit ligjor, përveç që është në kundërshtim me ligjin, mund të rezultoj me performancë të dobët dhe mos arritje të objektivave të ministrisë. Kjo, po ashtu mund të ndikojë edhe në mbivlerësimin e shpenzimeve reale për mallra dhe shërbimeve dhe nënvlerësimin e atyre për paga e mëditje.

Rekomandimi A1

Ministrja duhet t'i shqyrtoj arsyet pse rastet e tilla kanë ndodhur, dhe të ndërpres praktikat e angazhimit të përkohshëm të stafit për pozitat e rregullta. Në rast të nevojave për shërbime të veçanta, ato duhet të sigurohen duke ju nënshtruar kërkesave dhe procedurave ligjore.

3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime (përfshirë shërbimet komunale) në vitin 2018 ishte 4,618,168€. Prej tyre ishin shpenzuar 3,727,374€ apo 81% e buxhetit. Ato kanë të bëjnë me furnizime për zyrë, karburant për vetura, shpenzime për udhëtime jashtë vendi, mirëmbajtje dhe riparim të automjeteve, shërbime kontraktuese tjera, si dhe shpenzime komunale.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

[6] 23 prej tyre ishin në Ministri, 18 në Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor, dhe 3 në Agjencinë Pyjore të Kosovës.

3.1.4 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte në vlerë prej 46,655,993€. Prej tyre ishin shpenzuar 94%. Subvencionimi nga ministria bazohet në Programin për Bujqësi dhe Zhvillim Rural/PBZHR 2014-2020. Zbatimi i këtij programi bëhet në baza vjetore sipas Programit për Zhvillim Rural dhe Programit për Pagesa Direkte. Në vitin 2018 ministria kishte hartuar edhe një program të veçantë për "Zonat Rurale më pak të zhvilluara, ngritja e aftësive konkurruese në sektorin e bujqësisë dhe përfshirja e komunitetit në zhvillimin rural në regjionin e Mitrovicës Veriore dhe Masës për Investimet në Infrastrukturën Rurale. Hartimi i këtyre politikave bëhet nga departamenti për Zhvillimin e Politikave Bujqësore dhe Tregjeve si dhe nga Departamenti i Politikave të Zhvillimit Rural. Implementimi i tyre bëhet nga AZHB-ja, ndërsa pagesa e tyre realizohet nga departamenti i financave të ministrisë.

Ne kemi përzgjedhur 100 pagesa për zbatim të testeve substanciale, ndërsa çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë, janë trajtuar në Raportin e auditimit të performancës në fushën e granteve dhe subvencioneve, i cili është kryer nga Zyra Kombëtare e auditimit.

Me rastin e testimeve tona në fushën e subvencioneve, kemi identifikuar:

Çështja A2 - Menaxhim jo i mirë i paradhënieve për Investimet në Infrastrukturën Rurale

Gjetja

Sipas UA 09/2018, Kapitulli IV Masa Investimet në Infrastrukturën Rurale, ***Neni 26 Pika 4,*** potencohet se në rast se granti që kërkohet nga ministria është 1,000,000€, atëherë aplikuesi duhet të ofrojë dëshmi se qarkullimi financiar në tri vitet e fundit është të paktën 3,000,000€***; sipas Nenit 27 Pika 2,*** ndërmarrja duhet të demonstrojë se mund t'i kryej detyrimet dhe borxhet rregullisht, pa vënë në rrezik funksionimin normal të ndërmarrjes; ***sipas Nenit 29 Pika 3.3,*** para kërkesës për pagesë përfituesit duhet t'i kenë të shlyera detyrimet tatimore, tatimin në të ardhura të korporatave dhe tatimet tjera të aplikueshme, dhe sipas ***pikës 3.5 të të njëjtit nen,*** projektet e financuara nga ky program nuk bënë të jenë të financuara edhe nga zyra e BE-së në Kosovë apo ndonjë donatorë tjetër.

Ne kemi vërejtur se tek aplikimi për grant nga kompania ''Zubin Potok'' e cila kishte aplikuar në konsorcium me kompaninë ''N.T.P RAD'' pasiqë si e vetme nuk e përmbushte kriterin e qarkullimit financiar prej 3,000,000€, kompania ''N.T.P RAD'' kishte bashkëngjitur vërtetimin tatimor i cili tregon që kompania kishte obligime të pashlyera ndaj shtetit. Kjo është në kundërshtim me nenin 27 pika 2 të UA të lartëcekur, edhe pse kishte një marrëveshje për shlyerjen e këtyre obligimeve. Ministria nuk kishte ndërmarr hapa shtesë të nevojshëm për të vërtetuar se sa ishte shuma e borxhit, kur është futur kompania në marrëveshje dhe a është duke u respektuar ajo, për t'u siguruar se kompania është në gjendje t'i kryej detyrimet rregullisht, pa vënë në rrezik kontinuitetin e ndërmarrjes.

Po ashtu, përfituesi i grantit ''Dhemetra Sh.p.k'', në dokumentet e ofruara kishte bashkëngjitur një projekt për të cilin kishte fituar përkrahje nga Agjencia për Zhvillim e Austrisë (ADA) për "Prodhimin e Plehut Organik" i lidhur me 01.08.2017 deri me 31.07.2020. Ministria kishte dalë në teren para aprovimit të grantit dhe kishte vërtetuar se kompania nuk kishte pasur investime për projektin të cilin e kishte fituar nga ministria, mirëpo nuk kishte ndërmarrë hapa tjerë të nevojshëm për të vërtetuar se kompania nuk është duke u financuar nga dy burime për të njëjtin projekt, që është në kundërshtim me kriteret e përcaktuara nga ministria.

Për më tepër, për katër përfituesit[7] e kësaj mase, vlefshmëria e vërtetimit tatimor të lëshuar nga ATK kishte skaduar para pagesës.

Rreziku Mos plotësimi i kritereve të përcaktuara me udhëzim administrativ, nga ana e përfituesve të subvencioneve, rrit rrezikun që fondet të shpenzohen nga përfitues jo meritor dhe të mos shfrytëzohen në përputhje me qëllimin e synuar, si dhe mundësinë për trajtim të pa barabartë të aplikuesve tjerë.

Rekomandimi A2 Ministrja duhet të kërkojë nga personat përgjegjës forcimin e mekanizmave për menaxhim dhe monitorim të shpenzimeve në fjalë, në mënyrë që të merret siguri e arsyeshme që paratë e dhëna të shfrytëzohen drejtë dhe në pajtim me objektivat e subvencioneve.

Çështja A3 - Mos raportim i duhur nga Grupet Lokale të Veprimit - GLV

Gjetja Sipas UA 10/2016 Kriteret për mbështetje të Strategjive Zhvillimore Lokale- Nën Masa 303.1 Paragrafi 3 thuhet se pas përfundimit të projektit, përfituesi duhet të sjell dëshmi, faturat, formularin e ditëve të punës së menaxherit dhe ekspertëve, si dhe CV e menaxherit, CV e ekspertit, procedura se si është zgjedhur menaxheri apo eksperti, para se të marr edhe 20% të shumës së mbetur e cila paguhet pas përfundimit të projektit. Në rast të mos përmbushjes së këtij kushti, GLV-ja obligohet t'i kthej mjetet e pranuara.

[7] (a) N.T.P Arena Engineering – Përfitues i granitit për projektin "Rritja dhe Therja e brojlerëve" në vlerë investimi prej 2,000,000€. (b) Novus Sh.p.k- Përfitues i granitit për projektin "Ndërtimi i Tregut të Produkteve Bujqësore" në vlerë investimi prej 2,000,000€. (c) Dhemtra Sh.p.k- Përfitues i grantit për projektin "Ndërtimi i Kapaciteteve për prodhimin e plehut Organik" në vlerë investimi prej 2,000,000€ dhe (d) Zubin Potok D.O.O - Përfitues i granitit për projektin "Investime në objekt për ruajtjen dhe magazinimin e frutave" në vlerë investimi prej 2,000,000€.

Në tri (3) raste[8] të testuara në vlerë prej 23,000€, përfituesit nuk i kishin arsyetuar në mënyrën e duhur shpenzimet. Përfituesit nuk kishin ofruar ndonjë dëshmi për përfitimin e arritur nga realizimi i shpenzimit, ashtu siç ishte paraparë me projekt. Në asnjë nga tri rastet nuk ishin bashkëngjitur dëshmi rreth punësimit të ekspertit. Në një rast mungonte kontrata e ekspertit të angazhuar për trajnime, në disa raste kishte mospërputhje mes agjendës së trajnimit dhe listës së pjesëmarrësve të nënshkruar, si dhe në një rast në të njëjtën ditë ishin mbajtur dy trajnime nga dy ekspertë dhe në dy listat e nënshkruara nga pjesëmarrësit në trajnime figuronte emri i tre personave të njëjtë duke përfshirë edhe emrin e ekspertit/ligjëruesit, si pjesëmarrës në trajnimin e ekspertit tjetër.

Rreziku Mos respektimi i kritereve të përcaktuara me program si dhe mungesa e monitorimit dhe e raportimit të mënyrës së realizimit të projektit, rrit rrezikun që ministria të mos i arrij objektivat e synuara.

Rekomandimi A3 Ministrja duhet të forcojë kontrollet e aprovimit të pagesave, për përkrahjen e GLV-ve, dhe në rastet ku raportimi i tyre nuk është në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara dhe me projektin e miratuar, të kërkohet kthimi i mjeteve siç parashihet me udhëzim dhe rregulloret tjera.

3.1.5 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 5,275,728€. Prej tyre në vitin 2018 ishin shpenzuar 2,733,505€, apo 52% e buxhetit. Ato kanë të bëjnë kryesisht me ndërtimin dhe rehabilitimin e sistemit të ujitjes në Kosovë, pyllëzimin e sipërfaqeve të zhveshura dhe mirëmbajtjen e tyre, softuerin - sistemi i integruar informativ bujqësor si dhe furnizime me pajisje të TI dhe pajisje laboratorike. Për testim substancial, ne kemi përzgjedhur 24 pagesa me vlerë 2,339,862€, si dhe për testim të pajtueshmërisë 12 mostra me vlerë 2,496,759€. Testimet tona kanë vënë në pah gjetjet e më poshtme:

Çështja A4 Vonesa në realizimin e projekteve dhe shpenzime shtesë si pasojë e hartimit të dobët të projekteve dhe specifikimeve teknike nga njësitë kërkuese

Gjetja Ligji i Prokurimi Publik, neni 28 pika 10 parasheh se "Autoriteti Kontraktues është përgjegjës për hartimin e Projektit Ekzekutiv, dhe i cili në mënyrë obligative duhet t'i bashkëngjitet Specifikave Teknike, të cilat janë pjesë e dosjes së tenderit. Asnjë Autoriteti Kontraktues nuk i lejohet që të lëshojë dokumentacionin e tenderit pa bashkëngjitur përshkrimin e hollësishëm të projektit".

[8] GLV Agroturizmi, GLV Lumbardhi dhe GLV Natyra.

Për projektin "Ndërtimi dhe rehabilitimi i sistemit të ujitjes në Kosovë" me 1,654,285€, në shtator 2017 ishin lidhur kontratat me tre OE të ndryshëm për katër[9] segmente të ndryshme. Ne kemi vërejtur se tek të gjitha segmentet kishte vonesa në realizim sikurse edhe punime shtesë. Kontratat ishin përfunduar në fund të vitit 2018, ndërsa për dy nga katër segmentet ende nuk ishte bërë pranimi teknik i punimeve. Vonesat në kryerjen e punimeve dhe punimet shtesë kishin rezultuar me një kosto prej 379,012€. Kjo ka ndodhur si rezultat i projektimeve jo të duhura teknike dhe specifikimeve të mangëta teknike të cilat ishin hasur në terren gjatë implementimit të projekteve.

Rreziku Mos hartimi i duhur i specifikimeve teknike rrezikon mbarëvajtjen dhe implementimin e projekteve sipas planifikimeve si dhe krijon kosto shtesë për ministrinë dhe kjo ndikon direkt në mos arritjen e objektivave të përcaktuara vjetore të ministrisë.

Rekomandimi A4 Ministrja duhet të siguroj se do të aplikohen në mënyrë strikte kërkesat ligjore në përpilimin e specifikacioneve teknike nga njësitë kërkuese para përgatitjes së dosjes së tenderit në mënyrë që implementimi i projekteve të realizohet në kohë, dhe pa shpenzime shtesë.

Çështja B3 - Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve në kode ekonomike

Gjetja Në bazë të rregullave financiare, shpenzimet duhet të klasifikohen në pajtim me planin kontabël. Nga testimi i 24 pagesave kemi gjetur se në 5 prej tyre me vlerë të përbashkët 754,405€, shpenzimet e bëra për zgjerimin e sistemit të ujitjes në fshatra, ishin regjistruar gabimisht në kodin ekonomik 32100 (Toka), në vend se të regjistrohet në një nga kodet që janë të përafërta me këtë investim (psh. ujësjellësi) meqenëse për këtë lloj investimi nuk është paraparë kod i veçantë në planin kontabël.

Rreziku Regjistrimi i shpenzimeve në kodet joadekuate rritë rrezikun për paraqitje jo të drejtë të të shpenzimeve në PFV. Kjo, po ashtu, ka shkaktuar edhe mbivlerësim të vlerës së pasurive për vlerën e zhvlerësimit që nuk është kalkuluar.

Rekomandimi B3 Ministrja duhet të sigurojë që zyrtari i shpenzimeve e bënë klasifikimin e duhur të shpenzimeve nëpër llogaritë përkatëse sipas planit kontabël dhe rrjedhimisht edhe në pasqyra financiare. Në rast se asnjë nga kodet në plan kontabël nuk përputhet, atëherë duhet të kërkohet nga Thesari shtimi i një kodi të ri për sistemin e ujitjes.

[9] 1.Zgjerimit i sistemit të ujitjes në fshatin Pantinë dhe Samadraxhë - Vushtrri
2. Zgjerimi i sistemit të ujitjes në Prizren.
3. Zgjerimi i sistemit të ujitjes në fshatin Frashër-Mitrovicë; dhe
4. Zgjerimi i sistemit të ujitjes në fshatrat Piranë, Landovicë, Tupec dhe Krajë – Komuna e Prizrenit

3.1.6 Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale:

Çështja A5 Mangësi në procesimin e pagesave

Gjetja

Rregulla financiare Nr.01/2013 përcakton se të gjitha faturat që i pranon organizata buxhetore, duhet të paguhen brenda 30 ditëve në qoftë se nuk është paraparë ndryshe me kontratë. Sipas rregullave të Thesarit, fillimisht duhet të bëhet kërkesa për blerje, zotimi i mjeteve, procesohet urdhër-blerja, pastaj të pranohet malli apo shërbimi, dhe pas pranimit të faturës të ekzekutohet pagesa.

Ne kemi gjetur se nga 62 pagesa të testuara, në pesë (5) prej tyre me vlerë të përbashkët 358,589€ pagesat janë kryer pas afatit të paraparë ligjor. Vonesat ishin prej 2 deri në 62 ditë. Po ashtu, në 13 pagesa me vlerë të përbashkët 977,906€ në fillim ishte pranuar fatura, pastaj ishte bërë zotimi i mjeteve dhe urdhër blerja. Kjo ka ndodhur si pasojë e mos-zbatimit të rregulloreve për shpenzimin e parasë publike nga ana e zyrtarëve përgjegjës.

Rreziku

Vonesat në realizimin e pagesave të faturave si dhe pranimi i faturave para zotimit të mjeteve dhe urdhërblerjes, mund të ndikojnë në rritjen e obligimeve për periudhat e ardhshme në rast të pamundësisë së kryerjes së pagesës nga ana e ministrisë. Kjo mund të rezultojë edhe me padi nga ana e OE.

Rekomandimi A5

Ministrja duhet të vendos disiplinë financiare dhe të kërkoj nga zyrtarët financiar që me përpikëri të zbatojnë procedurat e shpenzimeve, dhe të gjitha faturat të paguhen brenda afateve të përcaktuara ligjore.

3.2 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Në PFV-të e MBPZhR-së janë prezantuar 41,626,343€ pasuri kapitale (me vlerë mbi 1000€), 362,252€ pasuri jo kapitale (me vlerë nën 1000€), si dhe 29,399€ stoqe. Auditimi ynë, përveç çështjes që është paraqitur në kapitullin 2.1 (Theksimi i çështjes), ka vënë në pah edhe çështjet në vijim:

Çështja C1 - Procedurat e brendshme për menaxhimin e pasurisë

Gjetja

Sipas Rregullores MF-Nr.02/2013-për menaxhimin e pasurisë, OB duhet të nxjerr rregulla të brendshme për menaxhimin e pasurive, Po ashtu, sipas nenit 19 paragrafi 4.3 të kësaj rregullore, është përgjegjësi e Komisionit për Inventarizimin e Pasurive jo financiare të bëjë harmonizimin e raportit të inventarizimit me regjistrat e pasurive.

Përmes testeve audituese ne kemi vërejtur se MBPZhR nuk ka nxjerrë procedura të brendshme për menaxhimin e pasurive. Komisioni i inventarizimit të pasurive e kishte hartuar raportin e inventarizimit, mirëpo nuk e ka bërë krahasimin e raportit të inventarizimit me regjistrat e organizatës para se të përgatiten PFV-të. Përveç kësaj, pajisjet e blera në vlerë 6,300€ nuk ishin regjistruar në regjistrin e-pasuria. Kjo ka ndodhur për shkak se nuk janë zbatuar me përpikëri dispozitat e rregullores për menaxhimin e pasurive.

Rreziku

Mos harmonizimi i regjistrit të pasurisë me gjendjen reale të konstatuar nga inventarizimi, mund të ndikojë që informatat e prezantuara në PFV të mos jenë të sakta, derisa mos evidentimi i pajisjeve në regjistrat e pasurisë rrit rrezikun që ato të keqpërdoren, humben apo tjetërsohen.

Rekomandimi C1

Ministrja duhet të inicoj hartimin e procedurave të brendshme për menaxhimin e pasurisë dhe të siguroj një menaxhim më efektiv dhe në pajtim me rregullat. Po ashtu, duhet të sigurojë që komisioni i për inventarizim të bëjë harmonizimin e raportit të inventarizimit të pasurive me regjistrat e organizatës para përgatitjes së PFV-ve të vitit 2019. Përveç kësaj, të gjitha pajisjet duhet të evidentohen në regjistrat e pasurive.

Çështja A6 - Mangësi në procesin e pranimit dhe instalimit të pajisjeve të blera

Gjetja Sipas Rregullës Financiare *02/2013* Për Menaxhimin e Pasurisë Jo Financiare *Neni 8 Pika 4.* Zyrtari Kryesor Administrativ me vendim formon Komisionin për Pranimin e Pasurisë jo Financiare që ka përgjegjësitë të bëjë verifikimin e sasisë, cilësisë, llojin dhe vlerën e pasurisë jo financiare të pranuar.

Ne kemi gjetur se në IBK, pranimi i pajisjeve të blera për dy[10] projekte me vlerë prej 1,009,510€ ishte bërë nga një person i vetëm. Kjo kishte ndodhur për shkak se nga ZKA nuk ishte formuar komisioni për pranimin e pajisjeve. Për më tepër, nga inspektimi fizik ne kemi gjetur se deri në muajin mars 2019 shumica nga këto pajisje nuk ishin futur në funksion edhe pse ato janë pranuar në dhjetor 2018. Kjo ka ndodhur për shkak të pamundësisë së krijimit të kushteve fizike për instalimin e pajisjeve, si dhe për shkak se stafi ka nevojë për trajnime shtesë për përdorimin e disa prej këtyre pajisjeve.

Rreziku Pranimi i mallit në mungesë të komisionit relevant të pranimit, mund të shpie në pranim të mallit jocilësor dhe jo në përputhje me kushtet e kontratës. Mos funksionalizimi i tyre bën që këto pajisje të zhvlerësohen ende pa filluar të punojnë.

Rekomandimi A6 Ministrja duhet të sigurojë që me rastin e blerjes së mallrave, të caktohen komisionet për pranimin e tyre konform dispozitave të rregullores në fuqi. Poashtu duhet të sigurohet se pajisjet të futen në funksion menjëherë pas blerjes, në mënyrë që ato të mos amortizohen duke qëndruar të pa përdorura.

[10] (a) Programi kombëtar për Inventarin e Tokave Bujqësore të Republikës së Kosovës me vlerë prej 809,610€ dhe (b) Ngritja e kapaciteteve laboratorike në Institutin Bujqësor të Kosovës me vlerë prej 199,900€.

3.3 Të arkëtueshmet

Llogaritë e Arkëtueshme kryesisht kanë të bëjnë me qiratë, dhe totali i tyre i paraqitur në PFV të 2018 është 1,789,210€. Pjesa më e madhe i përkasin APK-së dhe kanë të bëjnë me obligimin që kanë OE ndaj APK-së për rikultivimin e tokave pas shfrytëzimit të tyre.

Çështja C2 - Mos kryerja e obligimeve për shfrytëzimin e tokave bujqësore

Gjetja

Sipas nenit 30 pika 30.1 të Ligjit Nr. 02/L-26 - Toka bujqësore mund t'u ipet me qira personave fizik dhe juridik, vendas dhe të huaj të cilët merren me veprimtari bujqësore, me një afat të caktuar. Sipas kushteve të kontratave, pagesa e obligimit duhet të bëhet deri me datën 10 të çdo muaji vijues. Derisa nëse nuk paguhet qiraja, Qiradhënësi ka të drejtë ta ndërpresë kontratën.

Ne kemi vërejtur se në 17 raste, qiramarrësit e tokave bujqësore nuk i kishin paguar vlerën e obligimeve totale prej 805,839€. Për më tepër, në një rast ministria me datë 12.01.2018, kishte lidhur kontratë të re me kompaninë ''Patroni'' për tregtim të karburanteve, tetë (8) muaj para se t'i skadoj kontrata e vjetër. Kjo ishte bërë pas kërkesës së kompanisë për shkak se për marrjen e licencës të pikës së karburantit për shitje, i është nevojitur kontratë me afat më të gjatë. Megjithatë, pas nënshkrimit të kontratës se re, kompania në fjalë nuk kishte kryer obligimet e saj të cilat rrjedhin kontrata për shfrytëzimin e tokës me qira. Si shkak i mos pagesave më lart ishte monitorimi i dobët i kontratave të qiradhënies nga ana e ministrisë.

Rreziku

Monitorimi i dobët i kontratave të qiradhënies dhe mos zbatimi me konsistencë i detyrimeve nga këto kontrata, rritë rrezikun real që të hyrat e ministrisë nga dhënia e pronave me qira të jenë më të vogla, madje edhe të mos inkasohen fare.

Rekomandimi C2

Ministrja duhet të sigurojë monitorimin e zbatimit të kontratave për dhënien me qira të tokave bujqësore, në mënyrë që të sigurohet se kontraktuesit i kryejnë obligimet e tyre sipas marrëveshjes, në të kundërtën kontratat duhet të ndërpriten.

3.4 Obligimet e papaguara

Pasqyra e obligimeve të papaguara e prezantuar në PFV e vitit 2018 ishte 3,743,043€, ku 3,575,011€ nga to ishin obligime ndaj fermerëve. Ministria po ashtu ka prezantuar edhe 19,853,257€ obligime kontraktuale ndaj fermerëve për projektet e subvencionuara që pritet të përfundohen në vitin 2019. Për me gjerësisht, referojuni kapitullit 2.1 (Çështjet kyçe në auditim).

Çështja C3 - Vonesa në realizimin e pagesave të obligimeve.

Gjetja Afatet kohore për kryerjen e pagesave të granteve përcaktohen me udhëzuesit që i nxjerr ministria për zbatimin e programeve vjetore të aprovuara. Në bazë të këtyre udhëzuesve, pagesat duhet të bëhen 20 ditë pas marrjes së vendimit apo 40 ditë nga data e aplikimit për pagesë, përveç nëse tejkalimi i afatit bëhet për ndonjë arsye objektive.

Në 21 nga 23 mostrat e ekzaminuara, ne kemi vërejtur se pagesat kishin tejkaluar afatet e përcaktuara për pagesë. Vonesat në rastet e ekzaminuara ishin deri në tre muaj. Sipas shpjegimeve të menaxhmentit të ministrisë, kjo ishte si rezultat i mos alokimeve të duhura të buxhetit për shpenzim nga ana e ministrisë së financave.

Rreziku Praktikat e tilla të ministrisë shkaktojnë probleme serioze për fermerët apo përfituesit e këtyre fondeve, për shkak se të njëjtit mund të fillojnë aktivitetet dhe të hyjnë në obligime duke u bazuar në pagesat apo kompensimet që do t'i bëj ministria.

Rekomandimi C3 Ministrja duhet të siguroj se asnjë ndarje e subvencioneve dhe granteve nga ana e komisioneve përkatëse nuk do të bëhet para se fondet të jenë të sigurta dhe të gatshme për pagesë në përputhje me afatet kohore të përcaktuara me rregulloren. Problemet me alokimin e fondeve duhet të zgjidhen në bashkëpunim me Ministrinë e Financave.

4 Qeverisja e mirë

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmerr veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i listave kontrolluese të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat në fund të vitit i dorëzohen Ministrisë së Financave.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentët tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Përkundër përpjekjeve për të zhvilluar qeverisjen e mirë, ekziston një numër i dobësive të qeverisjes brenda MBPZhR veçanërisht në lidhje me llogaridhënien dhe cilësinë e raportimit menaxherial. Përgjigja efektive ndaj rekomandimeve të auditimit dhe operimi i një sistemi cilësor të auditimit të brendshëm, nuk janë të vendosura plotësisht, dhe komiteti i auditimit nuk është funksional. AZhB edhe pse kishte formuar drejtorinë e financave, që në fillimin të vitit 2018, ekzekutimi i pagesave ende vazhdon të bëhet nga ministria. Menaxhmenti i lartë i ministrisë dhe AZhB nuk kishin ndërmarrur veprime të mjaftueshme për të bërë të mundur funksionalizimin e këtyre strukturave brenda AZhB-së. Përveç 65 zyrtarëve të rregullt, 63 persona në AZhB janë të angazhuar përmes marrëveshjeve për shërbime të veçanta. Ata kryejnë detyra të rëndësishme pavarësisht faktit se këto detyra do të duhej të kryhen nga stafi i rregullt, marrë parasysh sa e ndjeshme është puna brenda agjencionit. Kontrollet ishin të dobëta edhe në menaxhimin e pasurisë, personelit, menaxhimit të subvencioneve dhe realizimin e projekteve kapitale.

4.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) në ministri, operon me katër anëtarë të stafit - Drejtori i NjAB dhe tre auditorë. NjAB kishte hartuar planin vjetor dhe strategjik të auditimit. Për vitin 2018 kishte planifikuar të kryente nëntë auditime, shumica prej tyre ishin fusha me rrezik të lartë. Deri në fund të vitit kishte kryer të gjitha auditimet e planifikuara. Po ashtu, gjatë vitit edhe AZhB kishte themeluar NjAB e cila operon me dy (2) auditor – drejtori i njësisë dhe një (1) auditor. Meqenëse ishte njësi e re, gjatë vitit 2018 NjAB ishte marrë kryesisht me dhënien e këshillave menaxhmentit në lidhje me proceset dhe aktivitetet operative, si dhe me njohjen e biznesit, me qëllim të përgatitjes së planit strategjik pesë vjeçar si dhe planit vjetor për vitin 2019.

Çështja C4 - Mos funksionimi i Komitetit të Auditimit

Gjetja Komiteti i Auditimit nuk ishte funksional as gjatë vitit 2018, siç kërkohet me udhëzim administrativ 11/2010 për themelimin dhe funksionimin e Komitetit të auditimi.

Rreziku Mos funksionimi i Komitetit të Auditimit rezulton me mungesë të monitorimit të punës të NjAB për të ofruar mbështetje menaxhmentit në vendimmarrje dhe të sigurojë që rekomandimet e auditimit janë trajtuar dhe zbatuar.

Rekomandimi C4 Ministrja duhet të sigurojë funksionimin e Komitetit i Auditimit, i cili duhet t'i rishikoj rezultatet e auditimit të brendshëm dhe veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti në lidhje me rekomandimet e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm.

4.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara. Menaxhmenti mban takime të rregullta, në baza javore, me të gjitha departamentet dhe njësitë e saj, duke raportuar dhe diskutuar për të gjitha aktivitetet e saj. Po ashtu, MBPZhR është përgjegjëse për të gjitha aktivitetet financiare dhe menaxheriale të agjencive të saj vartëse. Kryeshefat Ekzekutiv të Agjencive raportojnë tek Ministri, përderisa Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për konsolidimin e pasqyrave financiare. Për qëllime të konsolidimit të informatave dhe raporteve financiare, agjencitë dërgojnë raporte në departamentin e financave të MBPZhR-së. APK harton pasqyra finanaciare të cilat konsolidohen me ato të ministrisë.

Çështja A7 - Mos funksionalizimi i strukturave të formuara brenda AZHB-së

Gjetja AZHB, sipas draft-rregullores së funksionimit dhe draft-organogramit, është përgjegjëse për menaxhimin e procesit të subvencioneve (pagesave direkte dhe granteve) që nga aplikimi i përfituesit deri tek ekzekutimi i pagesës. AZHB që në nga fillimi i vitit kishte formuar drejtorinë e financave (drejtori financiar, zyrtari çertifikues dhe zyrtari zotues dhe zyrtari shpenzues). Pavarësisht kësaj, ekzekutimi i pagesave ende vazhdon të bëhet nga zyra qendrore e financave në Ministri. Kjo ka ndodhur për shkak se Ministria dhe AZHB nuk kishin ndërmarrë hapa të mjaftueshëm për ta proceduar rregulloren për aprovim në Qeveri.

Rreziku Mosfunksionalizimi i departamentit të financave/pagesave në AZhB mund të rezultojë në vonesa të pagesave për përfituesit dhe në kërkesa për punë shtesë në departamentin e financave të ministrisë. Po ashtu, kjo rezulton në shtyrje të akreditimit të kësaj agjencie dhe si pasojë në humbje të fondeve nga Komisioni Evropian.

Rekomandimi A7 Ministrja duhet të sigurojë ndërmarrjen e masave të nevojshme për procedimin e rregullores në Qeveri për aprovim, si parakusht për funksionalizimin e plotë të të gjitha departamenteve në kuadër të AzhB-së.

5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2017 të MBPZhR-së ka rezultuar në 21 rekomandime. Ministria kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2018, nga 21 rekomandimet e dhëna në vitin 2017, shtatë (7) rekomandime janë zbatuar, pesë (5) janë në proces, dhe nëntë (9) prej tyre nuk janë adresuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4.

Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2018

	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2017	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	PFV	Ministri duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes. Duhet të ndërmerren veprime që pasuria në pronësi të ministrisë të regjistrohet në regjistrin e pasurisë si dhe të gjitha pasuritë në posedim të ministrisë të shpalosen PFV. Gjithashtu duhet të siguroj që për pasurinë e shfrytëzuar nga personat privat ta rikthej nën kontroll përmes rrugëve ligjore.	Edhe këtë vit janë përsëritur çështje të njëjta.	Rekomandim i pa zbatuar
2	PFV	Ministri duhet të siguroj se shpalosja e obligimeve financiare të bëhet ndaras nga obligimet kontraktuale. Po ashtu, duhet të bashkëpunojë me Avokaturën Shtetërore për harmonizim të regjistrave, në mënyrë që të paraqiten të gjitha detyrimet kontingjente.	Rekomandimi lidhur me paraqitjen e obligimeve kontraktuale ishte zbatuar.	Rekomandim në proces të zbatimit.
3	Procesi i buxhetit	Ministri duhet të siguroj që hartimi i buxhetit është mbështetur mbi një analizë të detajuar të të gjithë faktorëve që ndikojnë në realizimin e buxhetit pa diferenca të theksuara mes planifikimit dhe shpenzimit të mjeteve.	Edhe këtë vit janë përsëritur pothuajse të njëjtat çështje.	Rekomandim i pa zbatuar
4	Pagat dhe Shtesat	Ministri duhet të siguroj që janë shqyrtuar rastet e identifikuara dhe të marrë masat e nevojshme për të siguruar se kompensimi i pagave për stafin e MBPZhR bëhet konform buxhetit të paraparë dhe në përputhje me vendimet e Qeverisë dhe kontratave të nënshkruara.		Rekomandim i zbatuar

5	Pagat dhe Shtesat	Ministri duhet të konsideroj mundësinë për inicimin e ndryshimit/përshtatjes së rregullores me rrethanat e reja në mënyrë që për departamentet e mbetura jashtë rregullores të përcaktohen detyrat dhe përgjegjësitë.	Është bërë Draft Rregullorja e re por ende nuk është aprovuar	Rekomandimi në proces të zbatimit
6	Pagat dhe Shtesat	Ministri duhet të siguroj që çdo marrëdhënie pune e lidhur brenda ministrisë të nënshkruhet nga Zyrtari Kryesor Administrativ si dhe për pozitat me ushtrues detyre, përmes procesit të rekrutimit t'i plotësojë me punonjës të rregullt.		Rekomandim i zbatuar.
7	Pagat dhe Shtesat	Ministri duhet të siguroj se punonjësit me kontrata për shërbime të veçanta të angazhohen me procedura rekrutuese sipas kërkesave ligjore. Dhe se, angazhimet e stafit në punë të bëhen vetëm sipas marrëveshjeve të nënshkruara.	Ministria vazhdon të ketë kontrata me MShV.	Rekomandim i pa zbatuar
8	Mallra dhe shërbime	Ministri duhet të sigurojë që janë analizuar arsyet për dobësitë e identifikuara dhe t'i forcoj kontrollet gjatë procesit të prokurimit. Të gjitha procedurat duhet të zhvillohen në pajtim me Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik.	Nuk kemi hasur ndonjë rast të tillë në vitin 2018.	Rekomandim i zbatuar
9	Subvencione dhe Transfere	Ministri duhet të siguroj që Autoriteti menaxhues harton programin me kohë me qellim të implementimit të masave në kohën e duhur dhe programet e aprovuara nuk përmbajnë gabime të cilat duhet të ndryshohen pastaj me udhëzimeve administrative. Po ashtu duhet të siguroj që janë vendosur afate për miratim të projekteve.	Edhe këtë vit janë përsëritur të njëjtat çështje.	Rekomandim i pa zbatuar
10	Subvencione dhe Transfere	Ministri duhet të siguroj që aprovimet për shtyrje të afateve bëhen sipas udhëzimit administrativ dhe se arsyet për shtyrje mbështeten me dëshmi.	Ministria përmes UA kishte bërë shtyrjen e afateve kohore për të gjithë përfituesit.	Rekomandim i zbatuar

11	Subvencione dhe Transfere	Ministri duhet të siguroj se autorizimi i pagesave bëhet vetëm në rastet kur dëshmohet se janë zbatuar kriteret të cilat kanë ndikuar në përfitimin e projektit si dhe procedimi i kërkesës për pagesë të bëhet konform afateve të përcaktuara me udhëzim administrativ.	Nuk kemi hasur ndonjë rast të tillë në vitin 2018.	Rekomandim i zbatuar.
12	Subvencione dhe Transfere	Ministri duhet të siguroj se kushtet vendosura në kontratë dhe udhëzim administrativ zbatohen nga zyrtarët përgjegjës të AZhB-së.	Nuk kemi hasur ndonjë rast të tillë në vitin 2018.	Rekomandim i zbatuar.
13	Subvencione dhe Transfere	Ministri duhet të siguroj se janë analizuar shkaqet e mos kompletimit të lëndëve dhe se lëndët e pa kontrolluara duhet t'i nënshtrohen procesit të kontrollit. Gjithashtu, duhet të siguroj se dosjet e përfituesve do të indeksohen sipas renditjes dhe dorëzohen në arkiv dhe se të njëjtat me rastin e kërkesave dorëzohen të kompletuara. Po ashtu duhet të shikojë mundësinë e krijimit të dosjeve elektronike.	Ministria nuk kishte formuar fare komisionin për monitorim të Ex-post Kontrolleve në vitin 2018.	Rekomandim i pa zbatuar
14		Ministri duhet të siguroj së janë vendosur kritere të qarta në program dhe udhëzime administrative që mos të ketë paqartësi në interpretimin e tyre. Po ashtu të sigurojë se komisioni për shqyrtim të ankesave vepron në pajtim me udhëzimet administrative.	Edhe këtë vit janë përsëritur të njëjtat çështje.	Rekomandim i pa zbatuar
15	Investime Kapitale	Ministri duhet të sigurojë se kontratat lidhen me OE të cilët i plotësojnë të gjitha kriteret e përcaktuara në dosjen e tenderit.	Në vitin 2018 nuk kemi vërejtur raste të tilla.	Rekomandim i zbatuar
16	Çështjet e përbashkëta MSH dhe IK	Ministri duhet të sigurojë që zyrtari i shpenzimeve e bën klasifikimin e duhur të shpenzimeve sipas planit kontabël dhe shpenzimet regjistrohen nëpër kodet përkatëse.	Edhe pse ministria kishte kërkuar nga MF hapjen e kodeve adekuate për regjistrim, kjo nuk kishte ndodhur për 2018.	Rekomandim në proces të zbatimit
17	Pasurit kapitale dhe jo kapitale	Ministri duhet të shtyjë procesin për hartimin e procedurave të brendshme për menaxhimin e pasurisë dhe të siguroj një menaxhim efektiv në pajtim me	Edhe këtë vit janë përsëritur të njëjtat çështje	Rekomandim i pa zbatuar

		rregullat. Po ashtu, duhet të sigurojë që komisioni i themeluar nga SP për inventarizim të shtrijë veprimin në gjithë ministrinë dhe të ofrojë një raport të plotë në pajtim me rregulloren mbi menaxhimin e pasurisë.		
18	Të Arkëtueshmet	Ministri duhet të sigurojë që dhënia në shfrytëzimin e tokave bujqësore bëhet vetëm në përputhje me kriteret e parapara me ligj, si dhe duhet siguruar që të ndërmerren hapa lidhur më arkëtimin e borxheve të vjetra.	Edhe këtë vit janë përsëritur të njëjtat çështje.	Rekomandim i pa zbatuar
19	Obligimet Papaguara	Ministri duhet të siguroj se ekzekutimi i pagesave bëhet në përputhje me afatet kohore të përcaktuara me rregulloren, si dhe të gjitha obligimet të prezantohen drejtë në raportin e obligimeve.	Edhe këtë vit janë përsëritur pothuajse të njëjtat çështje.	Rekomandim në proces të zbatimit.
20	Zbatimi i rekomandimeve	Ministri duhet të sigurojë që është zbatuar plani i veprimit, i cili i përcakton saktë afatet kohore për zbatimin e rekomandimeve të bëra nga Auditori i Përgjithshëm, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme.	Edhe këtë vit janë përsëritur të njëjtat çështje.	Rekomandim i pa zbatuar
21	Auditimi i Brendshëm	Ministri duhet të sigurojë funksionimin e Komitetit të Auditimit, i cili duhet t'i rishikoj rezultatet e auditimit të brendshëm dhe veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti në lidhje me rekomandimet e auditimit të brendshëm.	Edhe këtë vit KA nuk ishte funksional. Sa i përket rekomandimeve të AB këtë vit ishin zbatuar.	Rekomandim në proces të zbatimit.
Nr	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2018		
1	PFV	Ministrja duhet të siguroj shpalosjen e saktë të të gjitha informatave në PFV, përfshirë informatat në lidhje me pasuritë, pasuritë kontingjente dhe detyrimet kontingjente. Kësaj duhet t'i paraprij evidentimi dhe regjistrimi i tyre në regjistrat e ministrisë. Po ashtu, Ministrja dhe Drejtori i Përgjithshëm i IBK-së duhet të sigurojnë se janë ndërmarrë veprimet e duhura ligjore që pasuritë e shfrytëzuara nga personat privat të rikthehen nën kontroll të IBK-së.		
2	Realizimi i buxhetit	Ministrja duhet të siguroj monitorim sistematik të shpenzimit të buxhetit. Për tejkalimin e barrierave eventuale të identifikuara, duhet të përcaktohen masa konkrete dhe praktike në mënyrë që ekzekutimi i buxhetit të bëhet në harmoni me planin e shpenzimeve. Programet vjetore të bujqësisë duhet të aprovohen me kohë, për të mundësuar shmangien e bartjes së vazhdueshme të obligimeve për vitin pasues.		
3	Paga dhe	Ministrja duhet t'i shqyrtoj arsyet pse rastet e tilla kanë ndodhur, dhe të		

	Mëditje	ndërpres praktikat e angazhimit të përkohshëm të stafit për pozitat e rregullta. Në rast të nevojave për shërbime të veçanta, ato duhet të sigurohen duke ju nënshtruar kërkesave dhe procedurave ligjore.
4	Subvencione dhe Transfere	Ministrja duhet të kërkojë nga personat përgjegjës forcimin e mekanizmave për menaxhim dhe monitorim të shpenzimeve në fjalë, në mënyrë që të merret siguri e arsyeshme që paratë e dhëna të shfrytëzohen drejtë dhe në pajtim me objektivat e subvencioneve.
5	Subvencione dhe Transfere	Ministrja duhet të forcojë kontrollet e aprovimit të pagesave, për përkrahjen e GLV-ve, dhe në rastet ku raportimi i tyre nuk është në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara dhe me projektin e miratuar, të kërkohet kthimi i mjeteve siç parashihet me udhëzim dhe rregulloret tjera.
6	Investimet Kapitale	Ministrja të siguroj se do të aplikohen në mënyrë strikte kërkesat ligjore në përpilimin e specifikacioneve teknike nga njësitë kërkuese para përgatitjes së dosjes së tenderit në mënyrë që implementimi i projekteve të realizohet në kohë, dhe pa shpenzime shtesë.
7	Investimet Kapitale	Ministrja duhet të sigurojë që zyrtari i shpenzimeve e bënë klasifikimin e duhur të shpenzimeve nëpër llogaritë përkatëse sipas planit kontabël dhe rrjedhimisht edhe në pasqyra financiare. Në rast se asnjë nga kodet në plan kontabël nuk përputhet, atëherë duhet të kërkohet nga Thesari shtimi i një kodi të ri për sistemin e ujitjes.
8	Çështje të përbashkëta M&SH dhe I&K	Ministrja duhet të vendos disiplinë financiare dhe të kërkoj nga zyrtarët financiar që me përpikëri të zbatojnë procedurat e shpenzimeve, dhe të gjitha faturat të paguhen brenda afateve të përcaktuara ligjore.
9	Menaxhimi i Pasurive	Ministrja duhet të inicoj hartimin e procedurave të brendshme për menaxhimin e pasurisë dhe të siguroj një menaxhim më efektiv dhe në pajtim me rregullat. Po ashtu, duhet të sigurojë që komisioni i për inventarizim të bëjë harmonizimin e raportit të inventarizimit të pasurive me regjistrat e organizatës para përgatitjes së PFV-ve të vitit 2019. Përveç kësaj, të gjitha pajisjet duhet të evidentohen në regjistrat e pasurive.
10	Menaxhimi i Pasurive	Ministrja duhet të sigurojë që me rastin e blerjes së mallrave, të caktohen komisionet për pranimin e tyre konform dispozitave të rregullores në fuqi. Po ashtu duhet të sigurohet se pajisjet të futen në funksion menjëherë pas blerjes, në mënyrë që ato të mos amortizohen duke qëndruar të pa përdorura.
11	Llogaritë e Arkëtueshme	Ministrja duhet të sigurojë monitorimin e zbatimit të kontratave për dhënien me qira të tokave bujqësore, në mënyrë që të sigurohet se kontraktuesit i kryejnë obligimet e tyre sipas marrëveshjes, në të kundërtën kontratat duhet të ndërpriten.
12	Obligimet e papaguara	Ministrja duhet të siguroj se asnjë ndarje e subvencioneve dhe granteve nga ana e komisioneve përkatëse nuk do të bëhet para se fondet të jenë të sigurta dhe të gatshme për pagesë në përputhje me afatet kohore të përcaktuara me rregulloren. Problemet me alokimin e fondeve duhet të zgjidhen në bashkëpunim me Ministrinë e Financave.
13	Auditimi i Brendshëm	Ministrja duhet të sigurojë funksionimin e Komitetit i Auditimit, i cili duhet t'i rishikoj rezultatet e auditimit të brendshëm dhe veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti në lidhje me rekomandimet e auditimit të brendshëm dhe të

		jashtëm.
14	Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut	Ministrja duhet të sigurojë ndërmarrjen e masave të nevojshme për procedimin e rregullores në Qeveri për aprovim, si parakusht për funksionalizimin e plotë të të gjitha departamenteve në kuadër të AzhB-së.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të

cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinioni mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinioni i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Letër konfirmimi





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural/ Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja/ Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm
Kancalarija Generalnog Sekretara
Office of the Secretary General

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2018 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018 (në tekstin e mëtejmë "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimit, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tij.

Z. Kapllan Halimi

Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Data: 06 qershor 2019, Prishtinë.